VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT - 2018 -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

# REZOLUTË

## PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2017

**I. Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:**

Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në vijim (AIDSSH), si institucion i pavarur, i cili jep informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", dhe kuadrin ligjor që normon informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Strategjinë e këtij institucioni për identifikimin, mbledhjen, ruajtjen, arkivimin, përpunimin, digjitalizimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe informimin e subjekteve kërkuese me këto dokumente, sipas ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me autoritetet e tjera publike, si dhe institucionet homologe ndërkombëtare;

Anëtarësimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me statusin e vëzhguesit në Rrjetin Europian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete;

Angazhimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", si dhe të ligjeve të tjera bazë për funksionimin e këtij institucioni.

**II. Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2017 AIDSSH-ja:**

Ka propozuar miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", për procedurën e kalimit në administrim të Autoritetit të materialeve arkivore.

Ka identifikuar në një periudhë të shpejtë kohore dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që administroheshin nga autoritetet e tjera publike, deri në momentin e krijimit të institucionit, sipas ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Ka filluar punën për mbledhjen e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", por procesi ende nuk ka përfunduar.

Ka administruar një numër të konsiderueshëm kërkesash nga individë, institucione kushtetuese dhe autoritete të tjera publike, për kandidatë për t'u emëruar apo ngritur në detyrë në disa institucione shtetërore, kërkesa nga subjekte politike për kandidatë për deputetë, si dhe kërkesa nga subjekte kërkuese në cilësinë e deputetëve.

Ka përgatitur strategjinë e punës dhe planin e veprimit për vitin pasardhës, duke përcaktuar përparësitë dhe objektivat që duhet të realizohen për përmbushjen e detyrave që ligji i ka ngarkuar, atë të identifikimit, mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, informimit dhe edukimit qytetar.

Është investuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me struktura homologe të mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe ka pasur mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të huaj të fushës.

Ka marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare, Konferencën Vjetore të Rrjetit Europian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete, si rrjet i krijuar nga autoritetet e ngjashme në disa vende të Europës (Gjermani, Poloni, Bullgari, Sllovaki, Hungari, Çeki, Rumani), bazuar dhe mbështetur edhe në iniciativën e shprehur në rezolutat nr. 1096 (1996) dhe nr. 1481 (2006) të Asamblesë së Këshillit të Europës.

Është angazhuar në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me informimin e individëve, institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, të medias, studiuesve dhe garantimin e transparencës në procesin e informimit.

Ka marrë statusin e vëzhguesit në Rrjetin Europian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete.

**III. Kuvendi i Shqipërisë përgjatë vitit 2018 kërkon nga AIDSSH-ja:**

Përfundimin e procedurave për kalimin në administrim të Autoritetit të të gjithë dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, nga arkivat e autoriteteve publike që i kanë në administrim aktualisht.

Përmirësimin e procedurave të ndjekura për verifikim nga Autoriteti, sipas standardeve dhe eksperiencave më të mira të institucioneve homologe në ish-kampin socialist të Europës Lindore, me qëllim trajtimin me transparencë, objektivitet dhe profesionalizëm të kërkesave të qytetarëve.

Forcimin e kapaciteteve administrative, sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për studiuesit me fokus të veçantë krijimin e një arkivi digjital të integruar, me qëllim aksesin sa më të gjerë për subjektet e interesuara në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucionet dhe autoritetet publike dhe me donatorët, si dhe me organizatat homologe.

Realizimin e objektivave, në kuadër të Planit Strategjik 2017-2020, për të përmbushur detyrat që përcakton ligji nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Përmirësimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e subjekteve, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për vetë institucionin.

Të ndërtojë një strategji komunikimi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe të rinjve në veçanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që u përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshme të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të marra në mënyrë autentike nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.

Të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, që janë verifikuar dhe analizuar nga komisioni, i cili ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik" dhe atyre që janë verifikuar dhe analizuar nga AIDSSH-ja.

Të identifikojë dhe të analizojë dokumentet që mund të deklasifikohen, me qëllim bërjen publike për individët dhe studiuesit vendas dhe të huaj.

**IV. Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018 kërkon nga Nënkomisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut:**

Të ndjekë nga afër veprimtarinë e AIDSSH-së, si dhe të adresojë tek institucionet përgjegjëse çështje dhe problematika që kanë të bëjnë me veprimtarinë e AIDSSH-së dhe që përfshihen brenda fushës së respektimit të të drejtave të njeriut.

Miratuar në datën 28.6.2018